



Bazuar në nenin 58, pika (m), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, si dhe Rregulloren për ndarjen e subvencioneve Nr. 01/24729, datë 12.08.2015, Komuna e Deçanit shpall:

Thirrje Publike

Për mbështetje financiare të Organizatave Jo-Qeveritare dhe Klubeve Sportive

Ftohen të gjitha OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës të aplikojnë me projekte në këto fusha prioritare:

- **Kulturë dhe Trashëgimi Kulturor**

Projekte që synojnë promovimin, ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës lokale, përfshirë organizimin e aktiviteteve kulturore, festivaleve, ekspozitave, promovimin e artistëve lokalë dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale.

- **Turizëm dhe Zhvillim Lokal**

Iniciativa që kontribuojnë në promovimin e potencialit turistik të Komunës së Deçanit, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, promovimin e destinacioneve turistike dhe përfshirjen e komunitetit në aktivitete turistike.

- **Rini dhe Zhvillim i Kapaciteteve Rinore**

Projekte që fuqizojnë të rinjtë përmes edukimit joformal, zhvillimit të aftësive, inovacionit, vullnetarizmit, pjesëmarrjes aktive në shoqëri dhe përfshirjes në vendimmarrje.

- **Sport dhe Aktivitet Fizik**

Mbështetje për klubet sportive dhe iniciativat që promovojnë sportin, aktivitetin fizik, përfshirjen e të rinjve në aktivitete sportive dhe organizimin e garave apo eventeve sportive.

- **Vlera të Luftës së UÇK-së**

Projekte që kontribuojnë në ruajtjen, promovimin dhe edukimin mbi vlerat e luftës së UÇK-së, përfshirë aktivitete përkujtimore, edukative dhe dokumentuese.

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është: **100,000.00 €** (njëqindmijë euro).

Kriteret për aplikim:

- Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës, së paku 1 (një) vit para datës së publikimit të thirrjes publike.
- Programi i tyre duhet të jetë i fokusuar në fushat e përmendura më lart
- OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
- Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.
- Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të bashkangjitur në thirrje.
- Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme: Ndërtesa e Komunës së Deçanit, rruga "Jashar Salihu", Nr. 3, kati përdhese, në Zyrën Pritëse.
- Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
- Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune duke filluar nga data: **05.05.2026** deri me **29.05.2026**.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kopja e letërnjoftimit të përfaqësuesit të autorizuar të OJQ-së;
2. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (obligative);
3. Vërtetim nga ATK, që OJQ nuk ka obligime tatimore (obligative) dhe
4. Dëshmi e organizimit të aktiviteteve të ngjashme.
5. Konfirmimi i llogarisë bankare në emër të OJQ-së.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret specifike, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Vërejtje:

Aplikacionet e pakompletuara ose të dorëzuara jashtë afatit nuk do të shqyrtohen. OJQ-të mund të aplikojnë vetëm me një projekt. OJQ-të përfituese nga thirrjet e mëparshme duhet të kenë përmbyllur obligimet e tyre kontraktuale.


Kriteret përmbajtjesore të vlerësimit:

Me rastin e vlerësimit të projekt-propozimeve, Komisioni do të vlerësojë me sa vijon:

- a posedon OJQ-ja, kapacitete profesionale për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit /programit (a kanë aftësitë e duhura dhe aftësitë për zbatimin e projektit, si dhe njohuri në lidhje me çështjet që trajtohen në këtë ftesë)
- a posedojnë kapacitete të menaxhimit të mjaftueshme OJQ-ja (duke përfshirë personelin, pajisjet për të udhëhequr me projektin)?
- a është i përcaktuar ekipi i projektit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit?
- sa relevant është projekt-propozimi për qëllimet dhe fushat të ftesës publike (a ndërlidhet projekti me aktivitetet e parapara me politikat e fushës, të cilat i mbulon ftesa publike?)
- a janë objektivat e projektit/programit të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme?
- a janë aktivitetet e projektit / programit të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme?
- a janë kostot e projektit/programit reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit?
- a janë kostot e projektit në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projektit/programit? OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti (1) projekt në kuadër të kësaj ftese publike.

Dokumentet që duhet të plotësohen i gjeni në web faqen e komunës në linkun: <https://decan.rks-gov.net/njoftimet-konkurset/?tax=dokumentet-njoftimet-shpalljet>

Deçan, 05.05.2026



Kryetari i Komunës:

Bashkim Ramosaj

